



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR

NJOFTIM

Radio Televizioni Shqiptar njofton të gjithë të interesuarit, aplikues për vendin e lirë të punës, të plotësojnë dhe depozitojnë dokumentacionin si më poshtë:

1. Formularin e aplikimit për punësim ([kliko këtu](#))
2. Formularin e vetëdeklarimit ([FORMULAR VETËDEKLARIMI](#))
3. Jetëshkrim në gjuhën shqipe;
4. Fotokopje e kartës së identitetit(ID);
5. Referenca.

Dokumentacioni duhet të depozitohet pranë zyrës së Protokollit të RTSH-së ose aplikimit elektronik në adresën info@rtsh.al deri më 14 gusht 2026.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatëve.

“Orkestrant i II-të” në Orkestrën Simfonike të RTSH-së (Perkusion)

Kandidatët që aplikojnë për pozicionin "Orkestrant i II-të" Perkusion në Orkestrën Simfonike të plotësojnë kërkesat e përgjithshme si dhe kërkesat e veçanta të vendit të punës si më poshtë:

1.Kërkesat e përgjithshme të vendit të punës:

- 1.1 Të jetë shtetas shqiptar;
- 1.2 Të mos jenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë.

2. Kërkesat e veçanta të vendit të punës Orkestrant i II

- 2.1 Diplomë e arsimit të lartë në instrumentin përkatës nga Universiteti i Arteve ose një institucion i njohur ndërkombëtarisht.
- 2.2 Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga MASR (Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë)
- 2.3 Minimum 3 vjet përvojë si interpretues në orkestër profesionale simfonike, operistike dhe ansamble të ngjashme.
- 2.4 Aftësi leximi prima vista shumë të mira
- 2.5 Aftësi për të interpretuar me frazim dhe dinamike të pasu
- 2.6 Aftësi për të punuar në harmoni me kolegët e orkestrës dhe me dirigjentin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Program i kërkuar për “Perkusion”:

Programi për konkursin për pozicionin e perkusionit

Tamburo militare: Etyd 15 nga Keith Larson

Ksilofon: Etyd in D nga Morris Goldenberg

Vështirësi orkestrale për tamburo: Korsakov - Scherezade koha 3

Vështirësi orkestrale Piatti: Tchaikovsky - Uvertura "Romeo dhe Xhulieta"

Konkursi do të zhvillohet në ambjentet e Radio Televizionit Shqiptar datë 07 shtator 2026.